



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBETARE E MJEDISIT
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT ELBASAN

Nr. 517 Prot.

Elbasan, me 13.06.2016

Lenda: Mendim per VNM te thelluar per aktivitetin "Njesi Sherbimi 2 kt Thertore"sh.p.k .

Drejtuar: Sektorit te VNM
Drejtoria e Vleresimit Mjedisor
Agjencia Kombetare e Mjedisit

1. Subjekti : "RESTAURIM GURRA -KACA" Sh.P.K" NIPT K87706601M

1.1.NUIS : NIPT K87706601M

1.2.Administrator: Tahir Kaca

1.3. Adresa : Qarku Elbasan, Bashkia Librazhd, Zona Industrise, ish ndermarrja e ndertimit, Zona Kadastrale 2446, numuri pasurise 1/564

2.Veprimtaria dhe vendndodhja: "Njesi Sherbimi 2 kt Thertore "

Vendndodhja: Bashkia Librazhd, Zona Industrise, ish ndermarrja e ndertimit, Zona Kadastrale 2446, numuri pasurise 1/564

Siperfaqe prej 1.616km²; Kapaciteti vjetor i shfrytezimit 1500ton;

3. Pershkrimi i aktivitetit (pershkrimi teknologjise, lidhja me zonat e banuara, relievi, gjendja mjedisore, infrastruktura, rruga per ne objekt, etj). (Pershkrimin e proceseve ndertimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit);

Në këtë prone do të ndërtohet një objekt shërbimi 2kat. Ky objekt do të shërbejë si fabrike me funksion per distribucionin dhe perpunimin e produkteve blektorale. Sheshi i ndërtimit është i vendosur në një terren të sheshtë me siperfaqe totale 938 m² , ne buzë të rrugës dytësore. Aktualisht kjo pronë shfrytëzohet per depozitim e inerteve dhe materialeve te ndertimit. Rreth e qark pronës ndodhen nje banesa. Siperfaqja e shfrytezuat per ndertimin e viles eshte rreth 291 m², ndersa siperfaqja e vete ndertimit eshte 250 m². Te dhenat urbanistike te ndertimit te objekteve jane si me poshte:

Siperfaqja e tokes qe zhvillohet 938 m²

Siperfaqja e tokes e zene nga struktura 250 m²

Siperfaqja e pergjithshme e ndertimit 500m²

Lartesia maksimale nga niveli I tokes 6.8 m

Numuri i kateve mbi toke 2 kate

Numuri i kateve nen toke 0 kate

- Lartësia maksimale e ndërtesës mund të arrijë deri në 2 kat, bazuar në rregulloren e PPV-së mbi zhvillimin e objekteve
- Kuota ± 0.00 e objekteve të jetë jo më e lart se 60 cm nga kuota e trotuarit

Proceset teknologjike ne kete projekt jane ato te fazes ndertimore, nepermejt punimeve te ndertimit te cilat konsistojne si me poshte:

- Rrethimi i sheshit te ndertimit
- Germimi dhe hapja e themeleve te objektit
- Betonimi i themeleve
- Ngritja e struktures prej betoni dhe hekuri (betoni blihet i gatshem nga prodhuesit)
- Punimet e konstruksionit dhe te mbuleses se objektit
- Muratura, suvatimet, instalimet inxhinierike, rrjeti elektrik, u ujit, zjarrfikes, etj.
- Sistemimi i shesheve te lira rreth objektit, rruget hyrese e dalese
- Rehabilitimi i hapësirave te gjelberta te projektuara, etj.
- Punimet e brendshme te objektit si instalime inxhinierike, mobilim, etj.

Lendet e para te perdorura do te jene kryesisht betoni i cili blihet i gatshem nga firmat e prodhimit te betonit ne zone, hekuri per strukturen mbajtese te objektit, tulla per mbushjen e mureve dhe konstruksioni metalik per mbulesen, material poliesteroli per izolim, rere dhe gelqere per suvatimin e mureve, dyer dhe dritare druri dhe duralumini te gatshme, si dhe instalimet inxhinierike te ambjenteve te brendshme.

Punimet ndertimore dote zgjasin per nje periudhe prej 6muaj-1 vit.

Relievi Terreni. Aktiviteti ndodhet ne Bashkine Librazhd me nje relief fushor. Kjo zone ndodhet ne nivelin deri ne 150 mbi nivelin e detit. Ne siperfaqen ne studim kemi te bejme me toka per sherbim industrial.

Lidhja me zonat e banuara Objekti ndodhet në Bashkine e Librazhdit, eshte Zona Industriale, ish ndermarrja e ndertimit. Objekti eshte i lidhur pjeserisht me rruge te asfaltuar dhe rreth 100m rruga eshte e pashtruar e cila ka nevojte per sistemim.

Gjendja Mjedisore: Zhvillimi i aktivitetit te ndertimit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore. Shkarkimet ne mjedis gjate fazes ndertimore do te jene kryesisht pluhurat nga punimet e ndertimit , si dhe zhurmat ne mjediset e punes nga makinerite e punimeve te ndertimit, proceset e hedhjes se betonit, nga mjetet rrugore etj. Ky efekt mund te transmetohet edhe ne mjediset e zones perreth nese nuk kryhet larja dhe pastrimi i mjeteve para daljes se tyre nga kantieri dhe lagia e siperfaqeve te pa shtruara gjate sezonit te thate. Keto ndikime do te jene te perkohshme dhe nuk dote kene veti akumuluese ne mjedisin e zones.

Mbetjet e ngurta nga faza ndertimore do te jene ambalazhe te produkteve te ndryshme te cilat jane te riciklueshme .

Dheu qe do te largohet nga sheshi i ndertimit duhet te transportohet nga automjete qe plotesojne kriteret dhe kushtet e lejuara te ketij sherbimi, vendi i depozitimit te tij nuk eshte percaktuar ende

Per sasi ne nivele te vogla, do te kryhet sistemimi ne sheshin e ndertimit, duke rehabilituar siperfaqet e gjelberta dhe sheshet e rrugeve dhe te parkimit.

Ndikimi ne toke: duke qene se Ne siperfaqen ne studim kemi te bejme me toka per sherbim industrial.

Gjate punimeve do te kete largim te shtreses se tokes, ndikon ne mjedisin ku do te depozitohet kjo sasi dhe shtimi i siperfaqeve te betonuara dhe humbja e siperfaqeve te lira ndikon ne devijimin e statusit te zones dhe te proceseve natyrore si *filtrimi ujerave, pasurimi i tokes me lende organike etj.*

Ndikimi ne Biodiversitet: Kjo zone nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura me ligj, por ky ndertim, do te preke nje hapësire te gjelbert te zones (vetem me bimesi barishtore). Ne gjendjen qe eshte sot zona, nuk mbart vlere te larta peizazhistike, rekreative dhe te botes shtazore, kjo nga vete zhvillimi intensiv qe kjo zone ka patur vitet e fundit dhe historiku i saj si toka bujqesore. Brezi i pemeve dhe hapësirat e lira te zones ndikojne kryesisht per zogjte, te cilet vazhdojne te frekuentojne kete zone.

Nuk kemi ndotje te ujerave nentokesore. Ujerat qe dalin nga aktiviteti i ndertimit te objektit jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se kantierit, larjes se gomave te automjeteve dhe ujerat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varesi edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujerave dhe orientimi i tyre ne sistemin e kanalizimeve, pjeserisht ato filtrojne nentoke. Si rrjedhoje, punimet e ndertimit nuk duhet te tejzgjaten dhe te kalojne afatet e percaktuara ne lejen e ndertimit. Nuk duhet te shkarkohen lende te demshme ne mjedisin e kantierit pasi mund te filtrojne se bashku me ujerat e rreshjeve dhe si rrjedhoje te ndotin ujerat nentokesore. Ne kantier nuk do te magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk do te kete ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore. Mundesite e ndotjes, mund te vijne vetem nga derdhja e hidrokarbureve ose e lubrifikanteve gjate furnizimit te mjeteve te renda te punes.

Nje faktor tjetër mund te jene ujerat e pastrimit e te larjes se kazaneve te betoniereve gjate shkarkimit te betonit ne kantier.

Keto te fundit, nuk duhet te shkarkojne ujerat ne cdo mjedis rrethor, ato duhet te shkarkohen ne mjedis te caktuara dhe ne kantieret e prodhimit te betonit. Punimet e themeleve do te jene per nje periudhe kohore teper te shkurter dhe mundesia e ketyre ujerave zvogelohet ndjeshem.

Me daljen ne siperfaqe te xokles se objektit, reduktohet edhe kjo mundesi ndotjeje.

Persa i perket fazes se shfrytezimit mendojme se ka probleme per pastrimin e ujit. Eshte domosdoshmeri ndertimi i impiantit te pastrimit

Infrastruktura: Sheshi i ndertimit është i vendosur në një terren të sheshtë me siperfaqe totale 938 m², ne buzë të rrugës dytësore. Aktualisht kjo pronë shfrytëzohet per depozitimin e inerteve dhe materialeve te ndertimit. Ne pergjithesi infrastruktura eshte gjysem e gatshme.

Per ne objekt ekziston nje rruge e amortizuar, qe kerkon nderhyrje per permiresim. Rrjeti elektrik i ujit eshte i gatshem. Persa i perket rrjetit te shkarkimeve industriale eshte domosdoshmeri te ndertohet impianti i pastrimit te ujit.

4. Prania e burimeve ujore, objekteve te rendesishme, bimesia.

Ujrat siperfaqesore dhe nentokesore. Ne zonen e objektit nuk ka burime ujore nentokesore qe do te preken nga zhvillimi i aktivitetit, teknologjia e shfrytezimit te aktivitetit parashikon perdorimin e ujit. Ne VNM nuk eshte trajtuar infrastruktura e sistemi te pastrimit te ujrave. Ujrat duhet te dekantohen e pastrohen brenda territorit te subjektit. Rrjedhja e tyre te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale me ane te nje kanali anesor. Shkarkimet e ujerave te zeza, do te lidhen me sistemin ekzistues te kanalizimeve te zones. Aksesit do te kryhet nepermjet rruges ekzistuese dhe pastaj te derdhen ne Lumin Shkumbin.

Objektet te rendesishme. Nuk ekzistojne objekte te rendesishme, te trashigimise kulturore, arkitektonike dhe historike, tipare arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore. Ne rast konstatimi do te behet pezullimi i punimeve dhe do te njoftohen institucionet perkatese per te vendosur mbi ecurine e punimeve


Bimesia: Parcela është në kategorinë e tokë tërall. Zona e shfrytëzimit nuk ka fonde pyjore, zona të mbrojtur, parqe. Toka është inproduktive. Hartimi dhe zbatimi i projektit të shfrytëzimit nuk do të ketë ndonjë pasoje negative të mundshme në mjedisin e zonës, nëse do të trajtohet dhe problemi i pastrimit të ujërave.

4. **Mendimi ARM-se:** Mendimi ynë jepet në bazë të verifikimit në vend të shqyrtimit të dokumentacionit teknik e juridik të dërguar nga ana juaj, me datë 07.06.2016. Mendojmë se krahas masave dhe kushteve të përcaktuara nga ana juaj subjekti duhet të zbatohet për mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori ose nënkontraktuesit për zbatimin e projektit siç janë :

- Laga e shesheve të pa shtruara gjatë punimeve të ndërtimit dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri për të minimizuar ngritjen e grimcave të ngurta (pluhurave) në ajër.
- Gjatë transportit të perdoren mushamate e kamionave për të shmangur përhapjen e dheut e të inerteve në rruget e qytetit.
- Të merren masa që mjetet e transportit para se të dalin në rrugë të jenë të pastruara nga balta .
- Mbetjet e ngurta urbane që do të krijohen në objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga bashkia dhe të vendosen kosha të mjaftueshëm rreth objektit.
- Sistemi i shkarkimit të ujërave urbane dhe ato sipërfaqësore të jete të lidhur me sistemin e kanalizimeve të zonës.
- **Në dalje të objektit për fazën e shfrytëzimit, para se me u derdh në sistemin kryesor të kanalizimeve, të ndërtohet sistemi i pastrimit dhe trajtimit të ujërave teknologjike. (gje që në material nuk paraqitet)**
- Të sistemohet dhe rehabilitohen sheshet e liria dhe lulishtet e objektit pas përfundimit të punimeve në procesin karabina të objektit.
- Të respektohen oraret e qetesise publike dhe të mos punohet në orët e vona.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.
- Të miratohet menjëherë nga autoritetet një vend për depozitimin e dheut që dote largohet nga sheshi i ndërtimit.
- Të tregohet kujdes në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë si dhe masat për rigjenerimin e mjedisit, duke vendosur tabelat paralajmëruese dhe sinjalizuese për njerezit që do të punojnë në objekt. Ata duhet të jenë të trajnuar dhe të kualifikohen periodikisht duke bërë edhe instruktimin e sigurimit teknik.
- Subjekti të marrë masa për mbjelljen e bimesise autoktone karakteristike të zonës përgjatë perimetrit të zonës së shfrytëzimit.
- Mbetjet e riciklueshme që krijohen nga aktiviteti i ndërtimit si vajra, goma, hekurishte të depozitohen në një vend të caktuar (magazine) dhe t'u jepen subjekteve të licensuara.
- Të kryhet procesi i monitorimit rreth objektit gjatë procesit të ndërtimit. Për çdo përfundim monitorimi të informohet AKM-ja dhe ARM-ja. Si dhe çdo proces tjetër sipas natyrës së tij.

6.Foto nga objekti



7. Raporti i konsultimit me Publikun: nga ana e subjekti dhe eksperteve nuk eshte zhvilluar konsultim me publikun. Ne si ARM materialin e derguar nga ana Juaj ja derguam Bashkise Librazhd e cila dha mendimin pozitiv per zhvillimin e procedurave

DREJTORI

Lutfi GJINISHI

